

Ismail Qemali
Qemali



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Tatjana Xani

Alberik Beslis
Alberik

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 343/2 Prot

Vlorë, më 15.02.2023

VENDIM
Nr. 6, datë 15.02.2023


PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE DERI NË MASËN 20% NË PROGRAMIN E
STUDIMIT BACHELOR NË "FINANCË", BACHELOR NË "KONTABILITET" DHE
BACHELOR NË "EKONOMIKS", NË FAKULTETIN E EKONOMISË PËR VITIN
AKADEMIK 2023-2024

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, nenit 38, pika 1 shkronja dh, neni 75 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1 gërma ë të statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë VKM nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, të degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioni të arsimit të lartë", si dhe referuar shkresës nr.324 prot, datë 13.02.2023 të Zëvendësrektorit Akademik, Senati Akademik në mbledhjen e datës 15.02.2023

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimet e Departamentit të Ekonomiksit dhe Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, Fakulteti i Ekonomisë, për riorganizimet e programeve ekzistuese, deri në masën 20%, për vitin akademik 2023-2024 si më poshtë:

- Programi i studimit "**Bachelor në Ekonomiks**",
 - ❖ Hiqet lënda karakterizuese me kod ECN 328. "Rritja ekonomike dhe Teoritë e Rritjes me 6 kredite .
 - ❖ Shtohet lënda plotësuese me kod ECN 377 "Praktika Profesionale" me 6 kredite .
- Programi i studimit "**Bachelor në Financë**",
 - ❖ Lënda karakterizuese e programit FIN 318 "Bazat e pasurive të paluajshme" ishte me 7 kredite, bëhet me 6 kredite.
 - ❖ Lënda karakterizuese e programit FIN 317 "Vendimet Financiare të Korporatave" ishte me 7 kredite, bëhet me 6 kredite.



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- ❖ Lënda karakterizuese e programit FIN 226 "Teknika Bankare" ishte me 6 kredite, bëhet me 7 kredite.
 - ❖ Lëndët me zgjedhje FIN 352 "Auditim" dhe FIN 313 "Kontabilitet i Aplikuar" ishte me 7 kredite, bëhet me 6 kredite.
 - ❖ Lëndët me zgjedhje: DRE 263 Legjislacion Tregtar/ CSE 290 Sistemet e Informacionit në Ekonomi/ BIZ 201 Komunikimi në Botën e Biznesin ishin me 5 kredite, bëhen me 4 kredite.
 - ❖ Te rubrika e lëndëve plotësuese shtohet lënda FIN 397 "Praktika Mësimore" me 3 kredite.
- Programi i studimit "**Bachelor në Kontabilitet**",
- ❖ Lënda karakterizuese e programit FIN 314 "Kontabilitet Ndërkombëtar" ishte me 7 kredite, bëhet me 6 kredite dhe kalon në Vitin e Dytë me kodin FIN 214.
 - ❖ Në rubrikën e lëndëve karakterizuese shtohet në vitin e Tretë lënda FIN 352 "Auditim" me 6 kredite.
 - ❖ Lënda karakterizuese e programit FIN 340 "Tregjet Financiare" ishte me 7 kredite, bëhet me 6 kredite.
 - ❖ Lënda me zgjedhje FIN 226 "Teknika Bankare" hiqet nga programi dhe zëvendësohet me lëndën FIN 264 "Kontabiliteti Publik", me 6 kredite.
 - ❖ Lënda DRE 260 "Legjislacioni Tregtar" kalon në rubrikën e lëndëve me zgjedhje ishte me 6 kredite, bëhet me 5 kredite.
 - ❖ Lënda FIN 313 "Kontabilitet i Aplikuar" në rubrikën e lëndëve plotësuese ishte me 7 kredite, bëhet me 6 kredite.
 - ❖ Te rubrika e lëndëve plotësuese shtohet lënda FIN 396 "Praktika Mësimore" me 3 kredite.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtuesit e Fakultetit të Ekonomisë, Zv/Rektori Akademik dhe Drejtoria e Edukimit të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve.
3. Nje kopje e ketij vendimi percillet per dijeni ne MAS

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

